

24 Shkurt, 2017

HLS PROJECT STUDIO
architecture • design



[Rilindja Urbane në Bashkinë Prrenjas]

*Projekti i Fushës së Re dhe Ambjenteve Ndhmëse për
Skuadrën e Futbollit të Bashkisë Prrenjas*



RELACION _RILINDJA URBANE PRRENJAS



1. Projekti i Fushës së Re dhe Ambjenteve Ndihmëse për Skuadrën e Futbollit Te Bashkisë Prrenjas

RELACION

2017



Aktualisht , skuadra e futbollit të qytetit Prrenjas luan në një fushë , që ndodhet midis pallateve dhe ndërtesave . Me rikonceptimin e hapësirave të bashkisë së re , që PPV ka propozuar si rrjedhojë e strategjive të reja të zhvillimit të territorit për të , një nga projektet pilotë që propozohet , është edhe zhvendosja e fushës ,në një pozicion të ri , në një sipërfaqe të re , në të cilën do të bëhet e mundur , ndërtimi i një fushe të re , e cila do të plotësojë standartet për një lojë dinjitoze , që do ti mundësoje skuadrës arritjen e rezultateve më të mira. Ambjentet ndihmëse , dhomat e zhveshjes do të jenë komode dhe me të gjitha kushtet.

Dhe jo vetëm kaq. Edhe sportdashësit dhe tifozët e skuadrës do të kenë mundësi ta ndjekin lojën e skuadrës në kushte të denja për ta .

Në fotot më poshtë , jepet një pasqyrë e qartë se në c"kushte ndodhet fusha aktuale dhe se si sportdashësit dhe tifozët ndjekin lojën e skuadrës së qytetit të tyre.





Fusha e re do të shkojë në një sipërfaqe e cila aktualisht është e lirë dhe pronë e bashkisë , gjë e cila nuk krijon kosto shtesë për shpronësimin e saj . Kjo hapësirë është parashikuar prej kohësh që do jetë për përdorim për ambiente sportive , dhe gjithashtu ka edhe nje VKM që e përcakton këtë .






Në propozimin tonë , kjo hapësirë është sistemuar dhe përshtatur në funksion të fushës së re . Përpara saj është sistemuar sipërfaqja që lejon hyrjen në fushe. Janë parashikuar edhe 50 vende parkimi , në shërbim të skuadrave, tifozëve dhe sportedashësve .

Fasada është trajtuar në lija të drejta e të thjeshta , të cilat i japin një linearitet të gjithë fasadës kryesore . Ky lineritet dhe kjo thjeshtësi përqafohen bukur nga pejsazhi natyror përreth , të cilin Prrenjasi e ka një nga karakteristikat e veta më të mira .

Fusha e re do të ketë përmasat standarte të kërkuara për një fushë futbollit , 105 X 70 , brenda vijave të bardha . Nën sipërfaqen ku do të jetë tribuna, ndodhen dhomat dhe ambjentet ndihmëse për skuadrën dhe gjyqtarët . Në momentin e hyrjes kryesore , në kuotën 0.00 , ndodhet një korridor i gjatë , i cili siguron shpërndarjen e lojtarëve nëpër dhomat e zhveshjes.




Do të ketë dhoma zhveshjeje për të dyja skuadrat që do të luajnë. Këto dhoma do të kenë nyjet e tyre sanitare , të pajisura me dushe dhe ëc. Nyjet sanitare janë grupuar në një bllok të vetëm , për të bërë të mundur përdorimin eficient dhe sa më funksional të hapësirës . Dhomat e gjyqtarëve do të jenë më vete , në fund të këtij korridori.

Në pjesën qendrore të planimetrisë , ky korridor primar lidhet me një korridor më të vogël , që bën të mundur daljen e skuadrave në zonën teknike, e më pas në fushë .




Tribuna kryesorë , eshte pozicionuar mbi keto dhoma . Ajo ka një kapacitet të parashikuar prej 420 vendesh të ulura , dhe rreth 70-80 vende në këmbë . Dalja e lojtarëve behet në pjesën qendrore të tribunes. Në këtë pjesë ka edhe një hapësirë të vogël teknike , që mund të përdoret edhe nga gazetarët dhe personeli mjeksor në ndihmë të lojtarëve .



Midis fushës së lojës dhe tribunës është lënë hapësira e sigurisë prej 5 m . Kjo hapësirë rrethohet edhe nga një mbrojtëse me rrjete , si një masë sigurie e detyruar , midis tifozëve dhe lojtarëve.

Fasada është trajtuar në lija të drejta e të thjeshta , të cilat i japin një linearitet të gjithë fasadës kryesore . Ky linearitet dhe kjo thjeshtësi përqafohen bukur nga pejsazhi natyror përreth , të cilin Prrenjasi e ka një nga karakteristikat e veta më të mira .



Në fasadën kryesore dominon ngjyra e bardhe , e thyer me pak ngjyrë gri dhe duke në pjesën qendrore të saj , blloku i hyrjes është trajtuar me ngjyrë të kuqe . Janë përdorur pikërisht keto ngjyra , e kuqja dhe e bardha , pasi të tilla janë edhe ngjyrat e fanellave të skuadrës .




Në të katër anët e fushës , janë vendosur 4 ndricues të mëdhenj , të cilët bëjnë të mundur që ndeshjet të luhen edhe gjatë orëve të pasdites .

Sigurisht që cilësia e tapetit do të jetë sipas standarteve ,po ashtu edhe drenazhimi i saj , duke siguruar kushte optimale për një lojë futbollit.

Fusha do të bëhet pjese integrale e zonës në të cilën do të vendoset , duke i dhënë asaj gjallëri dhe vitalitet . Ajo do të sjellë zhvillim edhe të shërbimeve dhe të një mjedisi ekzistues urban , rivitalizim të zonës dhe përdorim më të mirë të aseteve .

Ngjyrat e përdorura për fasadat janë përzgjedhur me shumë kujdes dhe janë si më poshtë:



(e kuqe);



(e bardhë e hirtë);



(veshja me pllaka

gri)

Veshja e sheshit përpara propozohet të shtrohet me pllaka betoni në ngjyrat e mëposhtme:

